

**URDHËR**  
**Nr. 165, datë 13.6.2022**

**PËR SHPALLJEN E NDRYSHIMEVE TË STANDARDIT KOMBËTAR TË  
KONTABILITETIT NR. 15, “PËR KONTABILITETIN DHE RAPORTIMIN  
FINANCIAR TË MIKRONJËSIVE EKONOMIKE (SKK 15)”**

Në mbështetje të nenit 3, pika 4 dhe pika 5, të ligjit nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 17.7.2019, “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit,

**URDHËROJ:**

1. Shpalljen e ndryshimeve të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 15, “Për kontabilitetin dhe raportimin financiar të mikronjësive ekonomike (SKK 15)”.
2. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**Delina Ibrahimaj**

**STANDARDI 15**  
**“PËR KONTABILITETIN DHE RAPORTIMIN FINANCIAR TË**  
**MIKRONJËSIVE EKONOMIKE”**  
**I PËRMIRËSUAR**  
**(I ndryshuar)**

Tiranë, Janar 2019Prill 2022

## FUSHA E ZBATIMIT

5. Ky Standard do të zbatohet nga të gjitha njësitë ekonomike të klasifikuara **mikronjësi** nga Ligji 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

mikronjësitë ekonomike që realizojnë jo më pak se 5 milion lekë dhe jo më shumë se 30 milion lekë të ardhura nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi).

## PËRKUFIZIMET KRYESORE

~~12. Mikronjësi ekonomike quhen njësitë ekonomike, që në datën e raportimit nuk tejkalojnë kufijtë e të paktën dy prej tri kritereve të mëposhtme: a) aktivi, 15 milionë lekë; b) të ardhurat nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi), 30 milionë lekë; c) numri mesatar i punonjësve gjatë periudhës raportuese, 10. Këto kritere duhet të plotësohen për dy vite të njëpasnjëshme.~~

23. Pasqyrat financiare duhet të paraqiten, të paktën çdo vit, siç kërkohet nga neni 9 i Ligjit nr. 25/18, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” ligji për kontabilitetin. Kur data e ndërtimit të pasqyrave financiare të një njësie ekonomike ndryshon nga data e parashikuar në ligjin për kontabilitetin, pra kur pasqyrat financiare vjetore paraqiten për një periudhë më të gjatë ose më të shkurtër se një vit, njësia ekonomike do të paraqesë, për periudhën që mbulojnë pasqyrat financiare edhe informacionin e mëposhtëm:

(a) arsyen e përdorimit të një periudhe më të shkurtër ose më të gjatë;

(b) faktin që shumat krahasuese në pasqyrat financiare dhe shënimet shpjeguese përkatëse nuk janë krejtësisht të krahasueshme me periudhat e tjera.

## DOKUMENTACIONI DHE MBAJTJA E REGJISTRIMEVE KONTABËL TË MIKRONJËSIVE

24. Sipas Ligjit nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 7 ligjit për kontabilitetin, regjistrimet kontabël justifikohen me dokumente kontabël, në formë dokumentare ose informatike, që sigurojnë besueshmërinë e tyre. Dokumenti kontabël mbahet si provë dokumentare gjatë gjithë periudhës kohore, të përcaktuar në nenin 8 të këtij këtij ligji. Për çdo regjistrim kontabël duhet të shkruhet origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimit ekonomik ose e ngjarjes. Po sipas këtij Ligji, neni 23, organi i drejtimit ekzekutiv të njësisë ekonomike dhe organi i tij mbikqyrës, të punësuar ose jo, janë përgjegjës solidarë për përmbushjen e të gjitha kërkesave, të parashikuara nga dispozitat e këtij ligji.

## DATA DHE RREGULLAT E HYRJES NË ZBATIM TË KËTIJ STANDARDI

60. Ky standard me ndryshimet përkatëse do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudhën kontabël, që fillon më ose pas datës 1 janar 2019~~2022~~. Ky standard Ndryshimet e miratuara në prill 2022 duhet të zbatohet në mënyrë prospektive nga data 1 janar 2019~~2022~~, d.m.th pa ndryshuar pasqyrat financiare krahasuese të vitit 2018~~2021~~, të cilat janë përgatitur sipas kërkesave ekzistuese të kontabilitetit.